

**TERMOCENTRALI VLORE SH.A
PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

Vlorë, më 19 /07/2019

PËRMBAJTJA

Raport i Auditorëve të Pavarur	
I. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2018	4
II. Pasqyra e Fitim/(humbje) dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2018	5
III. Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018	6
IV. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	7
V. Rirapaqitje e Pozicionit Financiare sipas SNK Nr. 1.	8
VI. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare	8
1. Informacion i përgjithshëm	8
2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)	9
2.1. Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale	9
3. Bazat e përgatitjes	10
3.1. Deklarata e pajtueshmërisë	11
3.2. Biznesi në vijimësi	11
3.3. Krahasueshmëria	11
3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes	11
3.5. Vlerësime dhe gjykime	11
4. Politikat Kontabël	12
4.1. Transaksionet në monedhë të huaj	12
4.2. Instrumentat financiarë	12
4.3. Inventarët	14
4.4. Aktive afatgjata materiale	14
4.5. Aktivët afatgjatë jo-materiale	15
4.6. Zhvlersimi i aktiveve jo-financiare	15
4.7. Kosto e huamarrjes	15
4.8. Të ardhurat	15
4.9. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit	16
4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	16
4.11. Tatimi mbi fitimin	16
4.12. Përfitimet e punonjësve	16
4.13. Transaksionet me palët e lidhura	17
4.14. Provizionet	17
4.15. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara	17
5. Aktivët afatgjata materiale	18
6. Inventarë	19
7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme	19
8. Shpenzime për t'u shpërndarë	19
9. Mjetet monetare	19
10. Kapitali	20
11. Hua afatgjata	20
12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime	20
13. Hua afatshkurtra nga KESH sh.a	20
14. Llogari të pagueshme tregtare	21
15. Detyrimet tatimore	21
16. Detyrime të tjera	21
17. Të ardhura nga shitja	22
18. Të ardhura të tjera	22

19. Materiale të para dhe të konsumueshme	22
20. Shpenzime personeli	23
21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	23
22. Shpenzime të tjera shfrytezimi	23
23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare	23
24. Rezultati Tatimore	24
25. Transaksionet me palët e lidhura	24
26. Manaxhimi i riskut financiar	25
27. Vlera e drejtë e instrumentave financiare	27
28. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara	27
29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar	27

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2018

shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018	Riparaqitur 31.12.2017
AKTIVET		
Aktivt afatgjata	8,937,978,998	9,522,275,971
Aktivt afatgjata materiale	5 8,937,978,998	9,522,275,971
Investime në Proçes	0	0
Aktivt afatgjata jomateriale	-	-
Aktivt afatshkurtra	8,937,978,998	9,522,275,971
Inventare	6 886,960,449	1,137,429,599
Llogari të arkëtueshme tregëtare	0	0
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7 45,165,227	58,612,271
Shpenzime për tu shperndarë	8 28,501,534	27,690,499
Mjetet monetare në arkë e në bankë	9 686,358,084	731,971,612
Totali i aktiveve	10,584,964,292	11,477,979,952
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali	(3,162,797,334)	(2,799,321,260)
Kapitali aksionar	31,204,000	31,204,000
Rezerva ligjore	1,560,200	1,560,200
Rezerva të tjera	225,747,682	225,747,682
Fitime/Humbje të mbartura	(3,057,833,142)	(2,736,405,996)
Fitimi /Humbje e ushtrimit	(363,476,074)	(321,427,146)
Totali i kapitalit	(3,162,797,334)	(2,799,321,260)
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata	2,958,272,770	4,261,937,026
Hua afatgjata	11 2,903,557,527	4,205,327,137
Grante,te ardhura të shtyra e të tjera detyrime	12 54,715,243	56,609,889
Detyrime të tjera afatgjata	-	-
Detyrime afatshkurtra	10,789,488,856	10,015,364,188
Hua afatshkurtra	13 10,088,944,810	9,491,749,312
Financime nga KESH -i	13.1 666,320,479	488,798,203
Llogari të pagueshme (furnitorë)	14 23,564,123	28,610,352
Detyrime Tatimore	15 2,425,655	2,365,206
Llogari të pagueshme të tjera	16 8,233,788	3,841,114
Totali i detyrimeve	13,747,761,626	14,277,301,214
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	10,584,964,292	11,477,979,954

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a



II. Pasqyra e Fitim/(humbje) dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2018

	shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018	Riparaqitur 31.12.2017
Te ardhura nga shitja energjise	17	-	-
Te ardhura te tjera	18	1,894,646	2,669,354
Materiale te para dhe te konsumueshme	19	(17,703,779)	(10,556,290)
Shpenzime personeli	20	(74,924,186)	(72,972,949)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	21	(584,756,973)	(585,188,048)
Shpenzime zhvlerësimi	21	(258,367,176)	
<u>Shpenzime te tjera</u>	22	<u>(66,461,407)</u>	<u>(48,680,274)</u>
Fitimi operativ		(1,000,318,874)	(714,728,207)
Te Ardhura /Shpenzime interesa Neto	23	(162,283,925)	(193,379,082)
Te Ardhura /Shpenzime kembimi Neto		822,690,131	586,680,143
Rezultati total financiare		660,406,206	393,301,061
Fitimi para tatimit	24	(339,912,668)	(321,427,146)
Efektet e tatimit te shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(23,563,406)	-
Fitimi i vitit		(363,476,074)	(321,427,146)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse			
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë		(363,476,074)	(321,427,146)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a



III. Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitime te Mbartura /Humbje te akumuluar	Fitimi (humbje) e vitit financiar	Totali
Pozicioni më 01 Janar 2018	KREDI	31,204,000	-	(2,681,613,226)	(321,427,146)	(2,971,836,372)
Ndryshimet +/- te riparaciqites				(54,792,770)		
Riparaqitur Pozicioni i më 01 Janar 2017	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(2,736,405,996)	-	(2,477,894,114)
Transaksionet me pronaret						
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël 2017					(321,427,146)	(321,427,146)
Riparaqitur Pozicioni më 31 dhjetor 2017	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(2,736,405,996)	(321,427,146)	(2,799,321,260)
Miratimi i rezultatit te vitit 2017					321,427,146	
Pozicioni më 01 Janar 2018	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(3,057,833,142)		(2,799,321,260)
Transaksionet me pronaret						
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël 2018					(363,476,074)	(363,476,074)
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(3,057,833,142)	(363,476,074)	(3,162,797,334)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a



IV. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018


	<i>Per vitin e mbyllur më 31.12.2018</i>	<i>Riparaqitur 31.12.2017</i>
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(209,716,543)	(147,637,597)
Fitimi para tatimit	(339,912,668)	(321,427,146)
Shuma e mare nga Permbarimi	-	-
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	584,756,973	585,188,048
Zhvleresimi i Llog.arketueshme	-	-
Efekte nga kursi Kermbimit per Huate	(869,137,125)	(597,764,939)
Efektet e tatimit te fitimit	(23,563,406)	-
Te ardhura nga grantet dhe subvencionet	(1,894,646)	(1,637,366)
Vlera kontabel neto e aktiveve te shitura	-	-
Efektet e tatimit te shtyre	-	-
Levizjet ne Kapitali Qarkullues		
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkët	13,447,044	(1,944,188)
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e shpenzime per tu shperndare	(811,035)	(1,243,485)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	250,469,150	51,839,692
Financim te tjera te KESH	177,522,276	133,713,355
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	(5,046,229)	5,133,103
Rritje/rënie në llogarite te tjera te pagueshme	4,392,674	305,689
Rritje/rënie në marredheniet me buxhetin	60,449	199,640
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(209,716,543)	(147,637,597)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata material	(460,000)	(1,530,001)
Rivleresimi i asetëve	-	-
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	(460,000)	(1,530,001)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Flukset monetare nga ndryshimet ne kapital (neto)	-	(54,792,770)
Hua te arketuara/paguar (neto)	164,563,013	196,003,602
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	164,563,013	141,210,832
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(45,613,530)	(7,956,766)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	731,971,612	739,928,379
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	686,358,083	731,971,613

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Eduard ALUSHI
Drejtor i Drejtorise Ekonomike

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a.



Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

V. Riparaqitje e Pozicionit Financiare sipas SNK Nr. 1.
Regjistrimet kontabël me poshte Referuar Raportit të Përmbledhje se rregulimeve kontabël për Termocentrali Vlorë sh.a. te Korrik 2019.
 Për të pasqyruar fshirjen e inventarit që lidhet me vitet para 2016, regjistrimi do të jetë:

Përshkrimi	Debi	Kredi
Fitime të pashpërndara	52,274,966	
Inventari, provigjoni për artikujt e vjetëruar		52,274,966

Për të pasqyruar shtesat në fshirjen e inventarit që i përket vitit 2016, regjistrimi do të jetë:

Përshkrimi	Debi	Kredi
Fitime të pashpërndara	66,000	
Inventari, provigjoni për artikujt e vjetëruar		66,000

Ne mënyrë të detajuar:

shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2018	Riparaqitur 31.12.2017	Ndryshime +/-	Per vitin e mbyllur më 31.12.2017	Riparaqitur 31.12.2016	Ndryshime +/-	Per vitin e mbyllur më 31.12.2016
AKTIVET							
Aktivët afatgjatë	8,937,978,998	9,522,275,971		9,522,275,971	10,105,934,018		10,105,934,018
Aktivët afatgjatë materiale	8,937,978,998	9,522,275,971		9,522,275,971	10,105,934,018		10,105,934,018
Investime në Proqes	0	0		0	0		0
Aktivët afatgjatë jo materiale	0	0		0	0		0
Aktivët afatshkurtra	8,937,978,998	9,522,275,971		9,522,275,971	10,105,934,018		10,105,934,018
Inventory	0	0		0	0		0
Llogari të arkëtueshme tregëtare	6 886,960,449	1,137,429,599 (52,340,566)		1,189,770,565	7,136,928,325 (52,340,566)		1,189,269,291
Llogari të arkëtueshme e të tjera	0	0		0	0		0
Shpenzime për tu shpërndarë	7 45,165,227	58,612,270 (2,151,804)		61,064,074	59,216,278 (2,151,804)		56,668,082
Mjetet monetare në arkë e në bankë	8 28,501,534	27,690,499		27,690,499	26,467,014		26,447,014
	9 686,358,084	731,971,612		731,971,612	739,928,329		739,928,329
Totali i aktiveve	1,646,985,294	1,955,703,981		2,010,496,751	1,957,519,996		2,012,312,766
	10,584,964,292	11,477,979,952 (54,792,770)		11,532,772,722	12,063,454,015 (54,792,770)		12,118,246,785
KAPITALI DHE DETYRIMET							
Kapitali	(3,162,797,334)	(2,799,321,260)		(2,744,528,490)	(2,477,894,174)		(2,423,101,404)
Kapitali aksionar	31,204,000	31,204,000		31,204,000	31,204,000		31,204,000
Rezerva ligjore	1,560,200	1,560,200		1,560,200	1,560,200		1,560,200
Rezerva të tjera	225,747,682	225,747,682		225,747,682	225,747,682		225,747,682
Fitime/Humbje të mbartura	(3,057,833,142)	(2,736,405,996) (54,792,770)		(2,681,613,276)	(1,579,939,643) (54,792,770)		(1,525,146,871)
Fitimi/Humbje e ushtrimit	(363,476,074)	(321,427,146)		(321,427,146)	(1,155,466,115)		(1,156,466,415)
Totali i kapitalit	(3,162,797,334)	(2,799,321,260) (54,792,770)		(2,744,528,490)	(2,477,894,174) (54,792,770)		(2,423,101,404)
DETYRIMET							
Detyrime afatgjatë	2,958,272,770	4,261,937,026		4,261,937,026	6,124,738,185		6,124,738,185
Hua afatgjatë	11 2,903,557,527	4,205,327,137		4,205,327,137	6,006,499,920		6,066,499,930
Grantet, te ardhura të shtyra e të tjera detyrime	12 54,715,243	56,609,889		56,609,889	58,717,255		58,247,255
Detyrime të tjera afatgjatë	0	0		0	0		0
Detyrime afatshkurtra	10,789,488,856	10,015,364,188		10,015,364,188	8,416,610,003		8,416,610,003
Hua afatshkurtra	13 10,088,944,810	9,491,719,312		9,491,749,312	8,367,431,704		8,032,346,856
Financime nga KESH-i	13.1 666,320,479	699,798,293		488,798,203	355,084,848		355,084,848
Llogari të pagueshme (furnitore)	14 23,564,123	28,610,352		28,610,352	23,477,249		23,477,249
Detyrime Tatimore	15 2,425,655	2,365,206		2,365,206	2,165,626		2,165,626
Llogari të pagueshme të tjera	16 8,233,788	3,811,114		3,811,114	3,535,425		3,535,425
Totali i detyrimeve	10,789,488,856	10,015,364,188		10,015,364,188	8,416,610,003		8,416,610,003
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	13,747,761,626	14,277,301,214 (54,792,770)		14,277,301,214	14,541,348,189 (54,792,770)		14,541,348,189
	10,584,964,292	11,477,979,954 (54,792,770)		11,532,772,724	12,063,454,015 (54,792,770)		12,118,246,785

VI. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 3862 ,date 18.06.2007 si dhe është regjistruar në QKR më datën 22.12.2007.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Portin e ri, "Komuna Qender", Vlorë.

NIPT-i i Shoqërisë është K72422003G. Administratori i Shoqërisë është Z.Besnik Këndezi.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi, importi, eksporti dhe furnizimi i energjisë elektrike . Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë.

Keshilli Mbikqyres përbëhet:

1. Ridvan Kaja	Kryetar
2. Mëno Besimaj	Anetar
3. Dardan Malaj	Anetar
4. Romeo Kara	Anetar
5. Miranda Lila	Anetar
6. Erideta Bashi	Anetar
7. Eglantina Troplini	Sekretare

Numri i të punësuarve deri më 31.12.2018 është 61 punonjës [2017-61].

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

1. SNRF 9 "Instrumentet financiare" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 Janar 2018);
2. SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018); [SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). SNRF 15 specifikon se si dhe kur një raportues i SNRF-ve do të njohë të ardhurat, si dhe kërkon që subjekte të tilla t'u sigurojnë më tepër informacion përdoruesve të pasqyrave financiare. Standardi zëvendëson SNK 18 "Të Ardhurat", SNK 11 "Kontratat e ndërtimit" si dhe një numër interpretimesh lidhur me të ardhurat. Zbatimi i standardit është i detyrueshëm për të gjithë raportuesit sipas SNRF-ve dhe zbatohet për pothuajse të gjitha kontratat me klientët: përjashtimet kryesore janë qiratë, instrumentet financiare dhe kontratat e sigurimit. Parimi bazë i standardit të ri është që shoqëritë të njohin të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve te klientët në shuma që reflektojnë shpërblimin (pagesën), për të cilën shoqëria pret të ketë një të drejtë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve. Standardi i ri gjithashtu do të rezultojë në dhënien e shënimeve shpjeguese më të zgjeruara rreth të ardhurave, dhënien e udhëzimeve për transaksionet që nuk janë trajtuar më parë në mënyrë gjithëpërfshirëse (për shembull, të ardhurat nga shërbimet dhe

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

modifikimet e kontratës) dhe përmirësimin e udhëzimeve për marrëveshjet me shumë elementë. Aplikimi i IFRS 15 nuk ka impakt në pozicionit financiar apo në performancën e Shoqërisë].-

3. Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione", - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018);
4. Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë);
5. Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara" - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018);
6. KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

I. Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

1. *Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019);*
2. *Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i asetëve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar);*
3. *SNRF 16 "Qiratë" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019);-*
4. *Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve" - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).*
5. *KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat" efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);*
6. *Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)" rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF -ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim të shmangies së mospërputhjeve dhe qartësim të formulimit (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2019).*
7. *Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019).*
8. *Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"-Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).*

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

9. *Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 Janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).*
10. *Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020);*
11. *SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas Janarit 2021);*

Shoqëria ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqëria.

3. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithëpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj në një të ardhme të parashikuar.

Për vitin 2017 dhe për vitin 2018, duke qënë se Termocentrali Vlorë sh.a. nuk është në funksion, Enti Rregullator i Energjisë ("ERE") nuk i ka miratuar një çmim prodhim të energjisë dhe për pasojë as kuotën fikse mbi bazen e të cilit TEC-i financohet nga Korporata Elektroergjitime Shqiptare. Për rrjedhojë edhe për vitin 2018 shoqëria nuk ka realizuar të ardhura dhe është me rezultat negativ. Mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë bëhet nga KESH sha.

Në rast të vazhdimit të mosfunksionimit të TEC-it, shoqëria mund të vendoset përballë vështirësive financiare dhe bllokimit të aktivitetit të saj **por mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë sh.a. do të bëhet nga KESH sha.**

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sha është një investim i KESH sha prej rreth 100 mln Euro që nga koha e marrjes në dorëzim është jashtë funksionit dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur nga shitja e energjisë, qëllimi për të cilën ai është ndërtuar.

3.3. Krahasueshmëria

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare të Raportimit Financiar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kurset e këmbimit	31.12.2018	31.12.2017
Euro/Leke	123.42	132.95
USD/Leke	107.82	111.10
GBP/Leke	137.42	149.95

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit si edhe investime të tjera tejet likuide.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivitet financiar të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur koston e tyre historike dhe përfshirjen e të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike.

4.4. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve Afatgjatë Materiale (AAM) llogaritet me **metodë linare** sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material për: (i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe Instalime; (iii) Makineritë e Paisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	50 vite
Ndërtime dhe instalime	20-50 vite
Makineri dhe pajisje	15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. në vitin 2012. Gjithashtu ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Paisjet të cilat janë blerë nga shoqëria vit pas viti, amortizimi i të cilave llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur**.

Ndërsa: (i) Mjetet e Transportit; (ii) Paisjet e zyrës; (iii) Paisjet Informatike llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur** sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet afatgjatë jo-materiale

Aktivitet afatgjatë jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve jo-materiale shqyrtohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vlerer e mbetur	25%
Licensa	Metoda linare	15%

Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve (Aktivitet afatgjatë jo-materiale) të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë (SNK 38), duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, ku edhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivitetet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

4.6. Zhvlersimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktivitet rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohej me një normë skontimi para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

4.7. Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjmë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.8. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur.

ERE për periudhën deri në fund të vitit 2014 ka aprovuar çmimin e shitjes së energjisë brenda kontekstit të modelit të tregut ku Shoqëria optimizon aktivitetet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme.

Për vitin 2017 dhe për vitin 2018 Shoqëria nuk ka kuota të caktuara nga ERE.

4.9. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogaritë

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.11. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.12. Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur shoqëria është e përkushtuar përfundimisht të mundësi realiste të rrethojë ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse shoqëria ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundur që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

4.13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.14. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.15. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

Vlera bruto e AAM me 31.12.2017	Toka	Ndertime	Ndertime & Instalime	Makinieri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Inventar ekonomik	Total
243,037,367	-	243,037,367	2,354,562,445	10,616,331,602	2,729,973	1,726,179	3,041,614	13,221,429,180
Shtesa gjate 2018	-	-	-	-	-	460,000	-	460,000
Vlera bruto e AAM me 31.12.2018	-	243,037,367	2,354,562,445	10,616,331,602	2,729,973	2,186,179	3,041,614	13,221,889,180
Amortizimi i akumuluar 31.12.2017	-	30,379,670	560,613,240	3,102,343,020	2,273,525	1,417,755	2,125,999	3,699,153,209
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit 2018	-	4,860,747	90,910,255	488,596,013	91,290	115,544	183,123	584,756,973
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2018	-	35,240,417	651,523,495	3,590,939,033	2,364,815	1,533,299	2,309,122	4,283,910,182
Vlera neto e AAM 2018	-	207,796,950	1,703,038,949	7,025,392,568	365,158	652,880	732,492	8,937,978,998
Vlera neto e AAM 2017	-	212,657,697	1,793,949,204	7,513,988,582	456,448	308,424	915,615	9,522,275,971

Për Ndërtime, Ndërtime dhe Instalime, Makineri e pajisje amortizimi llogaritet sipas viteve të jetëgjatësisë, ndërsa për Mjetet e transportit, inventaret Ekonomik amortizimi llogaritet sipas normave fiskale.

Shënime: Amortizimi i aktiveve llogaritet me metodë lineare sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material për: (i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe

Instalime; (iii) Makineritë e Pajisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes,

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve Amortizimi

Ndërtesa 50 vite

Ndërtime dhe instalime 20-50 vite

Makinieri dhe pajisje 15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. në vitin 2012. Ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Pajisjet te cilat janë blerë nga shoqëria në vite, amortizimi i të cilave llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur.

Ndërsa: (i) Mjetet e Transportit; (ii) Pajisjet e zyrës; (iii) Pajisjet Informatike llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

6. Inventarë

Balancat e inventarit më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Nafta	1,107,596,246	1,108,149,190
Materiale	85,603,532	81,502,082
Invenar imet	117,335	119,293
Zbritje Inventari	<u>(306,356,665)</u>	<u>(52,340,966)</u>
	<u>886,960,449</u>	<u>1,137,429,599</u>

7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Te tjera -Tecnimont	-	-
Te tjera te arketueshme (TVSH)	30,813,725	20,697,963
Te tjera te arketueshme	103,792	103,192
Tatim Fitimi	14,247,710	37,811,116
Akciza per tu rimbursuar	825,781,559	825,781,559
Zhvleresim i kerkeses per arketim per akcizen e naftes	<u>(825,781,559)</u>	<u>(825,781,559)</u>
	<u>45,165,226</u>	<u>58,612,271</u>

8. Shpenzime për t'u shpërndarë

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Shpenzime për tu shperndarë	28,501,534	27,690,499
	<u>28,501,534</u>	<u>27,690,499</u>

9. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Mjete monetare ne banke ne monedha te huaja (depozita)	622,187,888	667,214,607
Mjete monetare ne banke ne LEKE (depozita)	58,955,925	58,414,405
Mjete monetare ne banke ne monedhe huaj	7,817	1,346,409
Mjete monetare ne banke ne Leke	5,206,454	4,996,192
Mjete monetare ne arke	-	-
	<u>686,358,084</u>	<u>731,971,612</u>

Kushtet financiare per llogarinë depozitë:

- 1- shuma 5,041,224.18 Euro ; afati 6-mujore; norma interesit me baza vjetore 0.23%
- 2- shuma 59,650,812.30 lekë; afati 6 –mujor ; norma interesit me bazë vjetore 1.12%

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018
(Vlerat janë në Lek)

10. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Aksionet zotërohen 100% nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare .

31.12.2018

	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura	Kapitali i aksionar Lekë
KESH sha.	31,204.00	1,000.00	100%	31,204,000.00

Rezervat ligjore nuk kanë pësuar ndryshime , ato janë në vlerën 1,560,200 Lekë.

Rezervat e tjera të Shoqërisë nuk kanë pasur ndryshime dhe janë në vlerën 225,747,682 Lekë .

Fitim/humbjet e mbartura janë në vlerën (3,057,833,142)Lekë [2017: (2,736,405,996) Lekë].

Fitim/humbjet e vitit ushtrimore është në vlerën (363,476,074)Lekë [2017:(321,427,146)Lekë].

11. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Hua afatgjata	<u>2,903,557,527</u>	<u>4,205,327,137</u>
	<u>2,903,557,527</u>	<u>4,205,327,137</u>

12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	<u>54,715,243</u>	<u>56,609,889</u>
	<u>54,715,243</u>	<u>56,609,889</u>

13. Hua afatshkurtra nga KESH sh.a

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Hua afat shkurter	<u>9,268,069,251</u>	<u>8,787,326,575</u>
Interesa te huave	<u>820,875,559</u>	<u>704,422,737</u>
	<u>10,088,944,810</u>	<u>9,491,749,312</u>

13.1 Financime nga KESH-i

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Financime te tjera nga KESH sh.a.	540,452,020	405,663,225
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	96,158,000	66,178,000
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	2,481,553	2,481,553
Financim Energji Elektrike nga KESH	17,124,658	13,690,216
KESH sh.a. karburant per automjetet	785,209	785,209
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per	7,601,818	
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE	1,717,221	
	<u>666,320,479</u>	<u>488,798,203</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Furnitore vendas	4,044,670	7,583,685
Furnitore te huaj	19,519,453	21,026,667
	<u>23,564,123</u>	<u>28,610,352</u>

15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Sigurime shoqerore e shendetsore	1,380,340	1,358,921
Tatim mbi te ardhurat personale	995,816	958,598
Tvsh per tu paguar(neto)	-	-
Tatim Burim	49,500	47,687
Shteti tatim fitimi	-	-
	<u>2,425,655</u>	<u>2,365,206</u>
Numri punonjesve	61	61

16. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Paga per tu paguar personelit	3,509,125	3,498,961
Procese gjyqesore	4,351,477	
Honorare per KM	171,649	158,610
Personeli-detyrime te kerkuara	20,000	
Detyrime te tjera	88,200	88,200
Detyrime te Tjera	93,336	95,342
	<u>8,233,787</u>	<u>3,841,114</u>

17. Të ardhura nga shitja

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018*(Vlerat janë në Lek)*

Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Te ardhura nga shitja e energjise	-	-
	-	-

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Rimarje subvencioni per AAM te falura	387,480	484,452
Rimarje subvencioni per materiale te falur nga Italianet	1,507,166	1,152,915
Arketuar Alb-Siguracion per likuidim demi	-	259,968
Te ardhura (dhurim nga KESH) Nafte		772,019
Fitime nga gabime te lejuara	-	
	<u>1,894,646</u>	<u>2,669,354</u>

19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Materiale të para	552,944	623,455
Materialë ndihmës	16,200	489,100
Pjesë ndërrimi	5,892,248	1,360,430
Kimikate	3,327,677	4,000,506
Pajime sigurie	41,710	24,270
Materiale - elektrike	761,740	96,135
Materiale - Mekanike	452,765	393,429
Materiale - hidraulike	57,880	54,746
Materiale - Zyre	165,051	155,665
Materiale -Mirembajtje e sistemeve	262,500	-
Materiale per linjen e furnizimit ne det	37,600	168,107
Karburant per makinat	2,133,025	2,338,797
Vajra lubrifikante dhe vajra transformatori	293,650	12,780
Inventar i imet	1,958	872
Materiale te tjera	3,706,833	837,998
	<u>17,703,779</u>	<u>10,556,290</u>

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018
(Vlerat janë në Lek)

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Pagat bruto	52,822,801	45,271,910
Kontribute sigurmi shoqerore	9,822,290	9,541,468
Shpenzime te tjera per personelin	12,279,095	18,159,571
	<u>74,924,186</u>	<u>72,972,949</u>

21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Amortizimi i AAM	584,756,973	585,188,048
Shpenzime zhvlerësimi te arketueshe	258,367,176	-
	<u>843,124,149</u>	<u>585,188,048</u>

22. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Blerje energji ,avull,uje,tj	3,280,284	131,120
Mirembajtje dhe riparime	6,211,823	2,235,298
Shpenzime siguracione	29,168,965	30,944,515
Sherbime te tjera	10,269,030	2,252,479
Sherbim i ruajtjes dhe sigurise	9,288,576	9,036,616
Personel jashtë njesisë	2,423,280	2,230,100
Transferime, udhëtime, dieta	483,380	439,500
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	192,680	212,542
Shpenzime transporti	1,233,794	1,094,066
Shpenzime për shërbimet bankare	107,571	85,149
Gjoha dhe dëmshpërblime	3,802,025	18,889
	<u>66,461,407</u>	<u>48,680,274</u>

23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Te ardhura nga interesat e llog. bankare	2,282,877	2,633,947
Shpenzime nga interesat e llog.bankare	(3,789)	(9,427)
Shpenzime per interesa kredie afat gjate	(164,563,013)	(196,003,602)
Shpenzime nga vlersime te kursit kembimit valutore	(47,954,208)	(11,445,388)
Te ardhurat nga vlersimi kursit kembimit valutore	870,644,339	598,125,531
	<u>660,406,206</u>	<u>393,301,061</u>

24. Rezultati Tatimore

Përlllogaritja e rezultatit tatimore 2018 paraqitet si më poshtë :

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018
(Vlerat janë në Lek)

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Fitimi (Humbje) para Tatimit	<u>(339,912,668)</u>	<u>(321,427,146)</u>
Shpenzime te panjohura (Gjoha e interesa tatimore)	3,802,025	18,889
Shpenzime te panjohura te tjera	493,200,019	221,955,956
Humbje e mbartur nga viti kaluar	-	-
Fitimi (Humbje) Tatimore	<u>157,089,376</u>	<u>(99,452,301)</u>
Tatimi mbi Fitimin (15 %)	<u>(23,563,406)</u>	-
Fitimi (Humbje) NETO	<u>(363,476,074)</u>	<u>(321,427,146)</u>

25. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura me impakt në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse paraqiten si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2018</u>		<u>31 Dhjetor 2017</u>	
	<u>Të arketueshme</u>	<u>Të Pagueshme</u>	<u>Të arketueshme</u>	<u>Të Pagueshme</u>
KESH sha	-	13,649,503,778	-	14,185,874,652
KESH Kredia WB 38720 USD	-	2,539,110,661	-	2,616,353,130
KESH Kredia EBRD 33833 euro	-	4,781,361,549	-	5,150,559,212
KESH Kredia EIB 22706 euro	-	4,851,154,568	-	5,225,741,370
KESH Detyrim per interesa te kredise WB 38720 USD	-	137,343,071	-	94,576,673
KESH Detyrim per interesa te kredise EBRD 33833 euro	-	67,791,085	-	67,207,924
KESH Detyrime per interesat e kredise EIB 22706 Euro	-	615,741,404	-	542,638,141
Financime KESH SH.A.	-	540,452,020	-	405,663,225
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	-	96,158,000	-	66,178,000
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	-	2,481,553	-	2,481,553
Financim Energji Elektrike nga KESH	-	17,124,658	-	13,690,216
KESH sh.a. karburant per automjetet	-	785,209	-	785,209
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per sistemet IT	-	7601818	-	-
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE transmetim energjie	-	1,717,220.53	-	-

Të tjera informacione për palët e lidhura.

	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Administrator	1,440,000	1,440,000
Keshilli Mbikqyres	<u>2,423,280</u>	<u>2,130,000</u>
	<u>3,863,280</u>	<u>3,570,000</u>
	Nr	Nr
Administratore	<u>1</u>	<u>1</u>
Keshill Mbikqyres	<u>7</u>	<u>7</u>
	<u>8</u>	<u>8</u>

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018*(Vlerat janë në Lek)*

mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

Instrumenta me interes fikse	31.12.2018	31.12.2017
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interes variabel		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	12,171,626,778	12,992,653,712
	12,171,626,778	12,992,653,712

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2018			Total
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	45,165,227			45,165,227
Shpenzime për tu shperndarë	28,501,534			28,501,534
Mjete monetare në arkë dhe bankë	686,358,084			686,358,084
	760,024,845	-	-	760,024,845

Përshkrimi	31 Dhjetor 2017			Total
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	58,612,271			58,612,271
Shpenzime për tu shperndarë	27,690,499			27,690,499
Mjete monetare në arkë dhe bankë	731,971,612			731,971,612
	818,274,382	-	-	818,274,382

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018

(Vlerat janë në Lek)

pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2018				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	45,165,227	-	-	45,165,227
Shpenzime ter tu shperndare	28,501,534	-	-	28,501,534
Mjetet monetare në arkë e në bankë	686,358,084	-	-	686,358,084
shuma	760,024,845	-	-	760,024,845
Detyrimet e pagueshme të tjera	(34,223,566)	-	-	(34,223,566)
Interesa KESH	(820,875,559)	-	-	(820,875,559)
Financime KESH SH.A.	(540,452,020)	-	-	(540,452,020)
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	(96,158,000)	-	-	(96,158,000)
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	(2,481,553)	-	-	(2,481,553)
Financim Energji elektrike	(17,124,658)	-	-	(17,124,658)
KESH sh.a. karburant per automjetet	(785,209)	-	-	(785,209)
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per sistemet IT	(7,601,818)	-	-	(7,601,818)
KESH SH.A. - Transferim shpenzimesh per FEE transmetim energjie	(1,717,221)	-	-	(1,717,221)
Huate	(9,268,069,251)	(2,540,827,433)	(362,730,094)	(12,171,626,778)
shuma	(10,789,488,855)	(2,540,827,433)	(362,730,094)	(13,693,046,382)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2017	(10,029,464,010)	(2,540,827,433)	(362,730,094)	(12,933,021,537)

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2017				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	58,612,271	-	-	58,612,271
Shpenzime ter tu shperndare	27,690,499	-	-	27,690,499
Mjetet monetare në arkë e në bankë	731,971,612	-	-	731,971,612
shuma	818,274,382	-	-	818,274,382
Detyrimet e pagueshme të tjera	(34,816,672)	-	-	(34,816,672)
Interesa KESH	(704,422,737)	-	-	(704,422,737)
Financime KESH SH.A.	(405,663,225)	-	-	(405,663,225)
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	(66,178,000)	-	-	(66,178,000)
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	(2,481,553)	-	-	(2,481,553)
Financim Energji elektrike	(13,690,216)	-	-	(13,690,216)
KESH sh.a. karburant per automjetet	(785,209)	-	-	(785,209)
Huate	(8,787,326,549)	(3,633,678,487)	(571,648,660)	(12,992,653,697)
shuma	(10,015,364,162)	(3,633,678,487)	(571,648,660)	(14,220,691,309)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2017	(9,197,089,780)	(3,633,678,487)	(571,648,660)	(13,402,416,927)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2018*(Vlerat janë në Lek)*

	Më 31 Dhjetor 2018			Më 31 Dhjetor 2017		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	137,829,139	700,544,045	(562,714,906)	149,713,366	522,829,666	(373,116,300)
EUR	622,195,706	10,316,048,606	(9,693,852,900)	668,561,016	10,986,931,856	(10,318,370,840)
USD		2,676,453,732	(2,676,453,732)		2,710,929,802	(2,710,929,802)
GBP			-			-
CHF			-			-
Totali	760,024,845	13,693,046,383	(12,933,021,538)	818,274,382	14,220,691,324	(13,402,416,942)

27. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiarë. Aktivet financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiarë përbëhen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

28. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Në datën 30.01.2018 shoqëria ka regjistruar pronësinë e tokës mbi të cilën është ndërtuar Termocentrali Vlorë në ZVRPP Vlorë, Zona kadasale 8604 me Numer pasurie 47/89, volumni 39 faqe 118, lloji i pasurisë Pyll Vlorë sipërfaqe 14,000 m².


Toka nuk ka vlerë, kështu që nuk është përfshirë në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2018.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare



Eduard ALUSHI
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike



Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a

